

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR OFRUESIN E SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR “ALBCONTROL”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror “*Albcontrol*” ka për qëllim përcaktimin e formës së organizimit, të rregullave të funksionimit dhe të administrimit të ofruesit të shërbimeve të lundrimit ajror “*Albcontrol*”.

Ligji nr.96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, përcakton në nenin 85 se shërbimet e lundrimit ajror ofrohen nga një ent publik ose privat.

Aktualisht, në Shqipëri, shërbimet e lundrimit ajror ofrohen nga shoqëria, *ALBCONTROL*, sh.a., shoqëri e themeluar në datën 31.12.1998, e organizuar në formën e një shoqërie tregtare, e cila funksionon në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Objektivi kryesor i këtij projektligji është organizimi i *Albcontrol*-it në formën e një enti publik të pavarur, jobuxhetor, jofitimprurës, i cili vepron në interes publik dhe ofron shërbimet e lundrimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimeve të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, të ligjit nr.96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tyre.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji parashikon krijimin e entit publik “*Albcontrol*”. Veprimtaria e ushtruar nga *Albcontrol*-i përbën shërbim publik dhe nuk ka qëllim fitimin.

Albcontrol-i ofron shërbimet e lundrimit ajror, duke përfshirë menaxhimin e trafikut ajror, shërbimet e komunikimit, të lundrimit dhe mbikëqyrjes, shërbimet e informacionit aeronautik, shërbimet meteorologjike për lundrimin ajror dhe shërbimet e hartimit të procedurave të fluturimit në të gjithë hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë si dhe shërbime të tjera, në përputhje me standardet, parimet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi.

Duke qenë se ligji nr.96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 85 e përcakton ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror si ‘një ent publik ose privat’, është e nevojshme që *Albcontrol*-i të organizohet e të funksionojë si një ent publik, duke u përshtatur kështu me frymën e këtij ligji.

Ligji nr.96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 94/4 sanksionon gjithashtu se ‘ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror nuk është subjekt fitimprurës, por mbulon nevojat dhe operon me bilance, ku të ardhurat barazohen me shpenzimet’. Forma aktuale e shoqërisë *ALBCONTROL*, sh.a., si shoqëri tregtare, veprimtaria e së cilës rregullohet nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, bie ndesh me parashikimin e mësipërm ligjor. Kësisoj, organizimi i *Albcontrol*-it në formën e një enti publik, që ushtron veprimtari jofitimprurëse, është në përputhje me parashikimin e dispozitave të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë.

Albcontrol-i, si një ent publik i krijuar me ligj të posaçëm, ka mundësi të realizojë funksionet e tij nga ana ligjore të mirërregulluara, në mënyrë që të ushtrojë veprimtarinë e tij si ofrues i shërbimeve të lundrimit ajror në përputhje me standardet, rregullat dhe parimet ndërkombëtare si dhe legjislacionin e brendshëm në fuqi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me nenet 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe me detyrimet që burojnë nga Konventa Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), nga Konventa e *Eurocontrol*-i, nga marrëveshja shumëpalëshe për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit si dhe aktet juridike, të miratuara në zbatim të tyre.

Gjithashtu projektligji është në përputhje me ligjin nr.96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian megjithatë, në projektligj gjejnë pasqyrim të pjesshëm ose masa zbatuese të detyruara nga rregulloret evropiane, aktet, si më poshtë:

- Rregullorja (EC) nr.550/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 10 mars 2004 “Për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror në qiellin e vetëm evropian”;
- Rregullorja e Komisionit Evropian 2015/340 e datës 20 shkurt 2015 “Mbi kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror”, në pajtim me rregulloren (EC) nr.216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon rregulloren (BE) nr.805/2011;
- Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2017/373 e datës 1 mars 2017 “Mbi përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e menaxhimit të trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i ndarë në 5 krerë dhe përmban 23 nene, me përmbajtje, si vijon:

Neni 1, “Objekti i ligjit”, përcakton objektin e ligjit, i cili është përcaktimi i formës së organizimit, i rregullave të funksionimit dhe të administrimit të ofruesit të shërbimeve të lundrimit ajror “*Albcontrol*”.

Neni 2, “Fusha e veprimit”, përcakton se ky ligj zbatohet për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror, duke përfshirë menaxhimin e trafikut ajror, shërbimet e komunikimit, të lundrimit dhe mbikëqyrjes, shërbimet e informacionit aeronautik, shërbimet meteorologjike për lundrimin ajror dhe shërbimet e hartimit të procedurave të fluturimit në të gjithë hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3, “Përkufizime”, përfshin përkufizimet e termave kyç të përdorur në ligj.

Neni 4, “Stausi juridik”, përcakton statusin juridik të *Albcontrol*-it, si ent publik, jobuxhetor, veprimtaria e të cilit përbën shërbim publik dhe kryhet nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për çështjet e transportit ajror. *Albcontrol*-i gëzon pavarësi drejtuese, administrative, teknike dhe financiare.

Në nenin 5, “Shërbimet e ofruara”, detajohen shërbimet që ofron *Albcontrol*-i, ndër të cilat shërbimet kryesore janë: menaxhimi i trafikut ajror (shërbimet e trafikut ajror, menaxhimi i hapësirës ajrore dhe menaxhimi i fluksit të trafikut ajror); shërbimet e komunikimit, të lundrimit dhe mbikëqyrjes; shërbimet e informacionit aeronautik; shërbimet meteorologjike për lundrimin ajror; shërbimet e hartimit të procedurave të fluturimit.

Neni 6, “Parimet e përgjithshme”, përcakton parimet nga të cilat udhëhiqet *Albcontrol*-i në ushtrimin e veprimtarisë, të cilat janë: ushtrimi i veprimtarisë në përputhje me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil; ofrimi i shërbimeve të lundrimit ajror për Republikën e Shqipërisë, duke pasur përparësi garantimin e sigurisë në operim, efikasitetin dhe rrjedhshmërinë e trafikut ajror; garantimi i vazhdueshmërisë së shërbimeve të ofruara; zbatimi i politikave të shtetit shqiptar për zhvillimin dhe modernizimin e transportit ajror; kryerja e veprimtarisë jofitimprurese për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror sipas parimit të rikuperimit të plotë të kostos, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 7, “Kompetencat e *Albcontrol*-it”, detajon kompetencat e *Albcontrol*-it në ushtrimin e aktivitetit të tij, të cilat janë: ofrimi i shërbimeve të lundrimit ajror, të nevojshme për të garantuar sigurinë në operim, efikasitetin dhe rrjedhshmërinë e trafikut ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe aerodromet civile të publikuara në AIP Albania; menaxhimi efektiv i hapësirës ajrore dhe fluksit të trafikut ajror, si dhe përdorimi i sigurt dhe efikas i hapësirës ajrore nga të gjithë përdoruesit e saj, nëpërmjet aplikimit të konceptit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore; koordinimi i veprimeve me strukturat ushtarake për realizimin e misionit të patrullimit të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë; në rast emergjencash, lëshimi i lejeve për hyrjen apo daljen përtej kufijve të miratuar dhe pranimi i ndryshimeve të rrugës së fluturimit të një avioni; kryerja e investimeve për instalimin, mirëmbajtjen dhe rinovimin e sistemeve të operimit, teknologjisë dhe burimeve të energjisë; trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i personelit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rregulloret për trajnimin dhe licencimin e personelit; integrimi dhe harmonizimi i plotë i sistemeve, teknologjisë dhe informacionit në kuadrin e një qielli të vetëm evropian; zbatimi i standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit; llogaritja e kostos për njësi për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*) si dhe e kostos për njësi për shërbimet e ofruara në aerodrome dhe grupe aerodromesh; administrimi i të ardhurave nga tarifat për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*) nëpërmjet *Eurocontrol*-it; mbledhja e tarifave për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në aerodrome nga *Albcontrol*-i ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij; bashkëpunimi i *Albcontrol*-it, bashkërendimi

dhe harmonizimi i veprimtarisë me institucionet/entet publike dhe organizmat e tjerë kombëtarë si dhe strukturat ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil.

Neni 8, “Ministri”, përcakton raportin e ministrit përgjegjës për çështjet e transportit ajror me entin publik “*Albcontrol*”. Ministri është autoriteti më i lartë në fushën e aviacionit civil. Në zbatim të politikave dhe përparësive në fushën e aviacionit civil, ministri nënshkruan marrëveshje shërbimi me *Albcontrol*-in ose i delegon detyra. *Albcontrol*-i, në ushtrimin e veprimtarisë zbaton politikat e shtetit shqiptar në fushën e aviacionit civil dhe raporton te ministri të paktën një herë në vit.

Neni 9, “Organet drejtuese”, përcakton se sistemi i administrimit të *Albcontrol*-it është me dy nivele. Organet drejtuese janë: Këshilli Drejtues dhe drejtori i Përgjithshëm.

Neni 10, “Këshilli Drejtues”, përcakton se Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i *Albcontrol*-it. Gjithashtu, ky nen rregullon mënyrën dhe kriteret e emërimit si dhe afatin e rastet e mbarimit të mandatit të anëtarëve e të kryetarit të Këshillit Drejtues.

Neni 11, “Kompetencat e Këshillit Drejtues”, përcakton se Këshilli Drejtues ka këto kompetenca: miraton drejtimet kryesore të veprimtarisë së *Albcontrol*-it; miraton statutin e *Albcontrol*-it dhe rregulloren e brendshme; mbikëqyr administrimin dhe veprimtarinë e *Albcontrol*-it; miraton numrin e punonjësve të *Albcontrol*-it dhe nivelin e pagave e të shpërblimeve; miraton programin ekonomik vjetor dhe e paraqet për miratim te ministri; propozon te ministri kandidaturën për drejtor të Përgjithshëm të *Albcontrol*-it; miraton marrjen e kredive e të huave për nevoja të ushtrimit të detyrave dhe aktivitetit të *Albcontrol*-it; emëron dhe shkarkon audituesit ligjorë; miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportin e audituesve ligjorë; përzgjedh audituesit e brendshëm dhe miraton programin vjetor të auditimit; merr vendime për çështje të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të *Albcontrol*-it. Mënyra dhe procedurat e hollësishme të ushtrimit të detyrave të Këshillit Drejtues dhe zhvillimit të mbledhjeve përcaktohen në statutin e *Albcontrol*-it.

Neni 12, “Drejtori i Përgjithshëm”, përcakton mënyrën e emërimit të drejtorit të Përgjithshëm, kriteret e emërimit, afatin e qëndrimit në detyrë si dhe rastet e largimit nga detyra.

Neni 13, “Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm”, përcakton se drejtori i Përgjithshëm i *Albcontrol*-it ka kompetencat, si vijon: siguron ushtrimin e kompetencave e të përgjegjësive të *Albcontrol*-it në pajtim me legjislacionin në fuqi; ndjek të gjitha çështjet e sigurisë, teknike, operacionale, administrative,

financiare dhe ligjore, të lidhura drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me veprimtarinë e *Albcontrol-it*; drejton veprimtarinë administrative dhe organizative të *Albcontrol-it* dhe ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues; përfaqëson *Albcontrol-in* në marrëdhënie me të tretët si dhe në projektet dhe iniciativat kombëtare e ndërkombëtare të ndërlidhura me aktivitetet e tij; administron buxhetin dhe burimet financiare të *Albcontrol-it*; miraton strukturën organizative të *Albcontrol-it* në bazë të nevojave teknike, operacionale dhe administrative; emëron dhe shkarkon punonjësit e *Albcontrol-it*; kërkon thirrjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues, kur e konsideron të nevojshme; kryen të gjitha detyrat e tjera, që i ngarkon ky ligj, statuti dhe rregullorja e brendshme e *Albcontrol-it*.

Neni 14, “Marrëdhëniet e punës dhe personeli”, përcakton se marrëdhëniet e punës për punonjësit e *Albcontrol-it* rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Punonjësit e *Albcontrol-it*, që ushtrojnë funksione specifike dhe që kanë akses në zonat me siguri të kufizuar, i nënshtrohen kontrollit të së kaluarës sipas përcaktimeve të Kodit Ajror.

Neni 15, “Konflikti i interesit”, përcakton se gjatë veprimtarisë së tyre, anëtarët e Këshillit Drejtues, drejtori i Përgjithshëm dhe punonjësit e *Albcontrol-it* parandalojnë dhe shmangin konfliktin e interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 16, “Burimet e financimit”, përcakton burimet e financimit të *Albcontrol-it* dhe saktëson mënyrën e përdorimit të tyre.

- Përcaktimi i *Albcontrol-it*, si ‘ent publik jofitimprurës’, vjen jo vetëm si domosdoshmëri nga neni 94/4 i Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, por është edhe konform parimit të ‘rikuperimit të plotë të kostos’, të parashikuar në rregulloren mbi parimet për përcaktimin e kostos bazë për tarifat e rrugës dhe llogaritjen e tarifave për njësi, të miratuar nga shtetet kontraktuese të marrëveshjes shumëpalëshe të *Eurocontrol-it*. Në këtë rregullore, në pikën 3.2.2 të saj është parashikuar mënyra e trajtimit të diferencave në të ardhurat vjetore, i quajtur “mekanizmi i rregullimit”, ku përcaktohet se: “[...] nërikuperimi ose mbirikuperimi si rezultat i diferencës midis të ardhurave/të ardhurave dhe kostove do të bartet dhe do të përfshihet në bazën e kostos së vitit "n" ose për një periudhë deri në gjashtë vjet (për vitet “n - 1” deri në “n + 4”) [...]”. Në këtë prizëm, duke qenë se enti publik ‘barazon të ardhurat me shpenzimet’ dhe nuk është subjekt fitimprurës, këto të ardhura përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave.
- Burimi i të ardhurave nga fondet e buxhetit të shtetit është parashikuar si rast përjashtimor, në rrethana të jashtëzakonshme (kryesisht raste të forcës madhore, ku nga eksperiencia mund të përmendet rasti i pandemisë), kur enti

publik, për shkaqe që nuk varen prej tij, e ka të pamundur të ushtrojë veprimtarinë.

- Gjithashtu, sa i përket imunitetit nga urdhrat e ekzekutimit, specifikisht për fondet e përfituara nga tarifat e shërbimeve të lundrimit ajror (të cilat përdoren ekskluzivisht për të mundësuar ofrimin e këtyre shërbimeve), ky imunitet është i kufizuar në masën që këto fonde janë të domosdoshme për ushtrimin e shërbimit në interes publik. Rregulloret dhe organizmat ndërkombëtarë (si *Eurocontrol*) kufizojnë përdorimin e këtyre fondeve vetëm në funksion të ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror. Nga ana tjetër, cenimi i këtyre të ardhurave nga urdhra ekzekutimi të mundshëm rrezikon ofrimin e këtij shërbimi me interes publik, duke mohuar të drejtën për të përdorur transportin ajror jo vetëm për shtetasit shqiptarë por edhe për shtetasit e huaj që mbikalojnë hapësirën ajrore shqiptare apo që përdorin shërbimet nga/dhe për në терминалет shqiptare.

Më konkretisht, ky nen përcakton se *Albcontrol*-i nuk është subjekt fitimprurës. Burimet e financimit të *Albcontrol*-it janë fondet e përfituara nga tarifat e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*) dhe nga tarifat e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror në aerodrome për nisjen dhe mbërritjen e fluturimeve; fonde të buxhetit të shtetit, në raste të jashtëzakonshme dhe kur veprimtaria e *Albcontrol*-it cenohet nga shkaqe të pavarura prej tij; burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi. Burimet e financimit, *Albcontrol*-i i përdor për kryerjen e veprimtarive të veta sipas këtij ligji dhe përcaktimeve në statut. Fondet e përfituara nga tarifat sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij neni, përdoren ekskluzivisht për mbulimin e kostos së ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror dhe mundësimin e veprimtarisë së *Albcontrol*-it, në funksion të këtyre shërbimeve, sipas parimeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare dhe gëzojnë imunitet nga urdhrat e ekzekutimit, deri në masën e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit normal të *Albcontrol*-it.

Neni 17, “Tarifat për shërbimet e lundrimit ajror”, detajon mënyrën e llogaritjes së tarifave për shërbimet e lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*) dhe të tarifave për shërbimet e lundrimit ajror që ofrohen në aerodrome për nisjen dhe mbërritjen e fluturimeve, mënyrën e faturimit dhe të mbledhjes së këtyre tarifave, si dhe rastet e përjashtimit.

Neni 18, “Kostoja për njësi”, përcakton mënyrën e llogaritjes së kostos për njësi për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*) dhe për shërbimet e lundrimit ajror të ofruara në aerodrome dhe grupe aerodromesh.

Neni 19, “Kontabiliteti dhe pasqyrat financiare”, përcakton mënyrën e mbajtjes së llogarive, të kontabilitetit dhe të certifikimit e të publikimit të pasqyrave financiare të *Albcontrol*-it.

Neni 20, “Riemërtimi i certifikatave të operimit”, parashikon se *Albcontrol*-i, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, i paraqet Autoritetit të Aviacionit Civil kërkesën për ndryshimin e emërimit në certifikatat e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror. Deri në momentin e lëshimit të certifikatave të riemërtuara, shërbimet e lundrimit ajror ofrohen nga shoqëria “ALBCONTROL”, sh.a.

Neni 21, “Prishja e shoqërisë “Albcontrol, sh.a.”, përcakton se shoqëria “ALBCONTROL”, sh.a., priset pa kaluar në likuidim. Të drejtat, detyrimet dhe pasuritë e shoqërisë “ALBCONTROL”, sh.a., i transferohen *Albcontrol*-it. Aksionari i shoqërisë “ALBCONTROL”, sh.a., ka detyrimin të caktojë auditues ligjor për ndjekjen e procedurave të nevojshme.

Neni 22, “Aktet nënligjore”, përcakton që ngarkohet ministri që, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 8, dhe 12, pika 6, të këtij ligji.

Neni 23, “Hyrja në fuqi”, përcakton afatin e hyrjes në fuqi të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “Albcontrol, sh.a.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është propozuar nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE